

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
Ministarstvo za digitalizaciju i javnu upravu - Ministry of Digitalization and Public Administration
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - Odeljenje za upravljanje javnim službenicima - Department for the Management of Public Officials

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në pajtim me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në bazë të nenit 7, paragrafit 2 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me datë 11.06.2026 merr këtë:

Nr. prot: 1437/2026
Datë: 12.06.2026

VENDIM

Për shtyrje të afatit për përfundimin e verifikimit paraprak

I. Shtyhet për pesëmbëdhjetë (15) ditë afati për përfundimin e verifikimit paraprak në procedurat e rekrutimit:

1. Drejtor Ekzekutiv- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, me numër të procedurës RN00019645, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 27.04.2026; si dhe për pozitën,
2. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia për Inovacion dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, me numër të procedurës RN00019646;
3. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia e Sportit, me numër të procedurës RN00019647;
4. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia Antidoping, me numër të procedurës RN00019653;
5. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia Zhvillimit të Rinisë, me numër të procedurës RN00019655;
6. Drejtor Ekzekutiv- Insektorati për Trashëgimi Kulturor, me numër të procedurës RN00019656;
7. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, me numër të procedurës RN00019657;
8. Zëvendës drejtor i Përgjithshëm- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, me numër të procedurës RN00019658;
9. Sekretar i Përgjithshëm- Ministria e Shëndetësisë, me numër të procedurës RN00019659;
10. Drejtor Ekzekutiv- Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, me numër të procedurës RN00019662, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 28.04.2026; si dhe për pozitën,
11. Drejtor Ekzekutiv- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, me numër të procedurës RN00019663;
12. Drejtor i përgjithshëm- Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, me numër të procedurës RN00019664;

13. Drejtor i Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor, me numër të procedurës RN00019679, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 29.04.2026; si dhe për pozitën,

14. Udhëheqës i Divizionit për Harmonizimin Gjuhësor, me numër të procedurës RN00019683;

15. Udhëheqës i Divizionit për Kontrollin Gjuhësor, me numër të procedurës RN00019685.

II. Afati shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i përcaktuar në pikën I të këtij vendimi, llogaritet nga dita e përfundimit të afatit fillestar të verifikimit paraprak për secilën procedurë veç e veç.


III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është duke zhvilluar verifikimin paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar në procedurat e rekrutimit për pozitën: Drejtor Ekzekutiv-Agjencia Qendrore e Prokurimit me numër të procedurës RN00019637, të publikuara nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike më 25.04.2026, Drejtor Ekzekutiv- Thesari i Kosovës - me numër të procedurës RN00019638, Drejtor Ekzekutiv- Agjencia Kosovare për Standardizim, me numër të procedurës RN00019639, Kryeinspektor, me numër të procedurës RN00019640, Drejtor Ekzekutiv- Agjencia për Pronësi Industriale, me numër të procedurës RN00019641, Drejtor Ekzekutiv- Agjencia për Siguri Kibernetike, me numër të procedurës RN00019642.

Për shkak të nevojës për afat shtesë për shqyrtimin administrativ të aplikimeve dhe përmbylljen e verifikimit paraprak të të gjithë kandidatëve, në përputhje me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 7, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, është vlerësuar e nevojshme shtyrja e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak për pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



U.d. Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike